

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Hagë/ Gjykata Speciale: Thaçi ishte anëtar kyç në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal, inkurajoi krimet ndaj kundërshtarëve.Veseli, mori pjesë
ADRESA	https://tpz.al/hage-gjykata-speciale-thaci-ishte-anetar-kyc-ne-zbatimin-e-qellimit-te-pe-rbashket-kriminal-inkurajoi-krimet-ndaj-kundershtareve-veseli-mori-pjese-i333051
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 09:40:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 09:22:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	aac663877eee6c93ab83e88830dac4e65bceb18361f083ef840ed503303cdfd8
TEKSTI	14b7e33ecb86c9c5e9877f44b764b80dc02e9a92a65cd8fdc025b3877b63016c
PAMJA	2b93667ce7fbc8c0dac9d641f16302111c0ebda30b2ae40aa85b0b2a2e54db52

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	696af248af945029bad275d27c19c4d170367467792c09fdb7ad5a0fab21e022
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	479381fa2a49a22c779ba6938b50ec298f3d05b6f6a0c36ab6b39ef80d1b34ab
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/696af248af945029bad275d27c19c4d170367467792c09fdb7ad5a0fa21e022

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

11:36 Vendimi/ Haga shpall Thaçi penalisht përgjegjës për krime lufte, dënohet me 25 vite burg

11:22 Hagë/ Gjykata Speciale: Thaçi ishte anëtar kyç në zbatimin e qëllimit

BALLKAN, 16 SEPTEMBER 2026, 11:22

Hagë/ Gjykata Speciale: Thaçi ishte anëtar kyç në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal, inkurajoi krimet ndaj kundërshtarëve. Veseli, mori pjesë

tpz.al TPZ



Trupi gjykses konstatoi se Hashim Thaçi dha një kontribut thelbësor në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal. Sipas gjykatësit Charles Smith, Thaçi ishte anëtar kyç në zbatimin e këtij qëllimi.

Ai dhe të akuzuarit e tjerë emëruan persona besnikë në pozita të ndryshme për të ruajtur kontrollin brenda UÇK-së gjatë gjithë periudhës përkatëse, shtoi Smith. Sipas tij, shumë prej këtyre personave kryen krime ose ishin në dijeni të kryerjes së tyre.

"Thaçi dha kontribut të qenësishëm për zbatimin e këtij plani. Ishte anëtar kyç në formulimin dhe zbatimin e tij. Shumë prej personave besnikë që u emëruan kryen krime ose ishin në dijeni të kryerjes së krimeve në përputhje me qëllimin e përbashkët. Thaçi inkurajoi kryerjen e krimeve përmes publikimit të komunikatave dhe deklaratave politike, si dhe përdorimit të luftës speciale. Thaçi shprehu tolerancë dhe inkurajoi kryerjen e krimeve kundër kundërshtarëve. Thaçi mori pjesë personalisht në krime, përfshirë arrestimin, ndalimin dhe marrjen në pyetje të 13 parlamentarëve.

Më 11 qershor 1998, Behajdin Hallaçi shkoi në shtabin e UÇK-së. Thaçi dhe Veseli e morën Behajdin Hallaçin në pranga. Ai nuk u pa më kurrë dhe trupi gjykses është i bindur se ai u vra. Për të fshehur përgjegjësinë, personat në fjalë ndërmorën masa të ndryshme. Pas luftës, Thaçi dhe Veseli u përpoqën t'i jepnin rryshfet familjes së tij, me qëllim që të hiqnin dorë nga kërkimi i së vërtetës. Edhe Shaban Dahala u vra. Trupi gjykses konstatoi se Thaçi kishte dijeni për një numër të konsiderueshëm krimesh të kryera kundër kundërshtarëve, sidomos për keqtrajtimin dhe vrasjen. Ai nuk ndërmori asnjë hap për ndëshkimin apo parandalimin e këtyre krimeve. Ai mori pjesë në krime dhe i inkurajoi ato, si dhe ngriti në detyrë personat e përfshirë në këto krime", tha Gjyqtari.

Haga për Veselin: Ishte figurë kyçe në qëllimin e përbashkët kriminal, mori pjesë dhe inkurajoi

ide!

Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?

Nga Andi Bushati

Në Shqipërinë e sotme "revolucionin" ka emrin pjesëmarrje dhe alternativë

Nga Preç Zogaj

Teje e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori? Ola Xama tregon pse i duhet super

Gjykata në Hagë ka paraqitur gjetjet për rolin e Kadri Veselit në çështje, duke konstatuar se ai ishte figurë kyçe në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal.

Sipas gjykatësit Charles Smith, Veseli kontribuoi në identifikimin, sigurimin e informacioneve dhe neutralizimin e personave të konsideruar të dyshimtë. Gjykata tha gjithashtu se ai emëroi persona besnikë për zbatimin e planit, ndërsa shumë prej tyre kryen krime ose ishin në dijeni të tyre.

"Veseli dha kontribut në qëllimin e përbashkët kriminal. Ai kontribuoi në identifikimin, sigurimin e informacionit dhe neutralizimin e personave që konsideroheshin të dyshimtë. Veseli ishte anëtar kyç në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal. Ai emëroi persona besnikë për të siguruar zbatimin efektiv të planit. Shumë prej këtyre personave kryen krime ose ishin në dijeni të kryerjes së tyre. Veseli mori pjesë dhe inkurajoi krimet" tha Smith.

Gjykata Speciale: Selimi inkurajoi dhe mori pjesë në krime! Kishte dijeni për keqtrajtimet dhe vrasjet

Trupi gjykues konstatoi se Rexhep Selimi inkurajoi dhe mori pjesë në kryerjen e krimeve në mënyra të ndryshme. Sipas gjykatësit Charles Smith, Selimi mori pjesë edhe në arrestimin e 13 personave në Qirez.

"Rexhep Selimi ishte themelues i UÇK-së dhe anëtar i Shtabit. Ai kishte rol në shpërndarjen e komunikatave. Pozita e tij zyrtare si inspektor i përgjithshëm i dha më pak pushtet krahasuar me të tjerët. Selimi luajti rol thelbësor në zonat operative, por ky rol nuk ishte kriminal. Megjithatë, ai i inspektoi shpesh këto zona dhe mori raporte të shpeshta për persona të ndryshëm. Për shkak të përfshirjes së tij në sulmet e paraluftës, ai ishte plotësisht në dijeni se kjo ishte politika e UÇK-së. Ai emëroi persona besnikë në pozita kyçe. Shumë prej tyre kryenin krime ose ishin në dijeni të qëllimit të përbashkët. Selimi inkurajoi dhe mori pjesë në krime, në mënyra të ndryshme që përshkruhen në aktgjykim. Ai mori pjesë në arrestimin e 13 parlamentarëve në Qirez dhe ishte i pranishëm në disa vende krimesh të paraqitura në aktakuzë.

Selimi inkurajoi kryerjen e krimeve përmes pjesëmarrjes në luftë, mosmarrjes së veprimeve për parandalimin ose ndëshkimin e krimeve kur merrte raporte, si dhe krijimit të precedentit se krimet ishin të pranueshme, përmes pjesëmarrjes personale në to. Ai kishte dijeni për krimet ndaj kundërshtarëve, ndalimin e paligjshëm dhe keqtrajtimin e tyre. Kur u bë ministër i Rendit, ai ndërhyri për të siguruar lirimin e katër anëtarëve të UÇK-së, të cilët ishin ndaluar për krijimin e një qendre të paligjshme ndalimi. Ai nuk siguroi që UÇK-ja të vepronte në përputhje me detyrimet e saj sipas së drejtës humanitare ndërkombëtare. Përkundrazi, toleroi shkelje të rënda të kësaj të drejte", tha gjyqtari.

Haga/ Smith lexon gjetjet për Jakup Krasniqin, ja çfarë provoi gjykata

Gjykata në Hagë tha se Jakup Krasniqi ishte një nga personat që ndihmoi në hartimin dhe zbatimin e asaj që e cilëson qëllim të përbashkët kriminal.

Sipas gjykatësit Charles Smith, Krasniqi përdori rolin e tij si zëdhënës i UÇK-së për të promovuar politikën e shënjestrimit të kundërshtarëve, emëroi persona besnikë në pozita kyçe për zbatimin e saj dhe, megjithëse kishte dijeni për krimet që po kryheshin, nuk ndërmori hapa për t'i parandaluar ose ndëshkuar.

Gjykata tha gjithashtu se ai inkurajoi kryerjen e krimeve përmes komunikatave dhe deklaratave publike dhe se, së bashku me tre të akuzuarit e tjerë, ishte pjesë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale.

"Krasniqi ishte anëtar kyç në formulimin e politikës së shënjestrimit të kundërshtarëve. Ai përdori rolin e tij si zëdhënës i UÇK-së për formulimin e kësaj politike. Përmes publikimit të komunikatave dhe fjalimeve publike, ai inkurajoi kryerjen e krimeve kundër kundërshtarëve, përfshirë përmes luftës speciale të UÇK-së. Ai përhapoi dhe promovoi qëllimin e përbashkët kriminal. Emëroi persona besnikë në pozita kyçe dhe krijoi organe speciale me detyrën e

zbatimit të politikës kundër kundërshtarëve.

Në atë kohë kishte dijeni për një numër të konsiderueshëm krimesh të kryera kundër kundërshtarëve, por nuk ndërmori asnjë hap për parandalimin apo ndëshkimin e tyre. Ai i mohoi këto krime dhe e portretizoi UÇK-në si një organizatë që promovonte të drejtën ndërkombëtare. Trupi gjyqës konstaton se të katër të akuzuarit kishin një qëllim të përbashkët kriminal dhe synuan kryerjen e krimeve për realizimin e këtij qëllimi. Për këtë arsye, të katërt mbajnë përgjegjësi penale në kuadër të ndërmarrjes së përbashkët kriminale."



BALLKAN / 16 September 2026, 11:09

Gjyqi në Hagë, trupi gjyqës: U vërtetua arrestimi i paligjshëm i së paku 385 personave

BALLKAN / 16 September 2026, 10:15

Verdikti/ Kosova mban frymën pezull, në Hagë nis seanca e shpalljes së vendimit ndaj krerëve të UÇK-së

BALLKAN / 16 September 2026, 10:05

FOTOT/ Frikë për përshkallëzim në Hagë? Qeveria e Kosovës merr masa, rrethon me gardh metalik godinat, Policia në gatishmëri

BALLKAN / 16 September 2026, 09:15

Shpallet sot në 10.00 vendimi për ish-krerët e UÇK, rriten tensionet në Hagë! Prishtina pret në shesh, me një thirrje: Na i ktheni djemtë n'shpi!

BALLKAN / 15 September 2026, 23:14

8 orë dëshmi për vdekjen e këngëtarit Giorgios Mazonakis, mjekja mohon akuzat

BALLKAN / 15 September 2026, 23:00

Shtohen masat e sigurisë në Hagë/ Policia paralajmëron shqiptarët: Do të konfiskohen flamujt me shtiza dhe objektet e rrezikshme

BALLKAN / 15 September 2026, 22:50

Detaji i ri që po hetohet për vdekjen e Mazonakis/ Fotoja e fshirë iu dërgua një personi ende të paidentifikuar

BALLKAN / 15 September 2026, 22:29

Prishtina nuk fle sonte! Nis nata e pritjes për vendimin e Hagës ndaj ish-krerëve të UÇK-së

BALLKAN / 15 September 2026, 22:02

Marta Kos: Nuk negociojmë për dinjitetin e viktimave të gjenocidit, Serbia duhet të përballlet me të kaluarën

BALLKAN / 15 September 2026, 21:57

Qindra shqiptarë mblidhen para Gjykatës Speciale në Hagë në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së

BALLKAN / 15 September 2026, 20:48

Shtohen masat e sigurisë në Hagë para vendimit për Thaçin, Veselin, Selimin dhe Krasniqin

BALLKAN / 15 September 2026, 19:46

Miliona euro nga buxheti i Kosovës për të akuzuarit në Hagë/ Ja sa është paguar për mbrojtjen juridike

BALLKAN / 15 September 2026, 19:24

**Kosova në fokusin e NATO-s/
Këshilli i Atlantikut të Veriut
mblidhet, KFOR-i: Gati për çdo
skenar**

BALLKAN / 15 September 2026, 18:49

**Verdikti i Hagës, udhëzimi i
Komunës së Prishtinës për
shkollat: Ora e parë t'i
kushtohet UÇK-së**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.